STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 26 prill 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON SE PARKU SHTETEROR PLAZHI I ORIENTIT (ORIENT BEACH STATE PARK) DO TE HAPET TE SHTUNEN PAS RIPARIMEVE TE DEMIT NGA SUPER STUHIA SENDI (SANDY)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Governor Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Parku Shtetëror Plazhi i Orientit (Orient Beach State Park), që gjendet në kepin lindor të kryqëzimin verior të Long Ajlënd (Long Island), do të rihapet të shtunën, 27 prill, pas riparimeve të gjëra të dëmit të shkaktuar nga super stuhia Sendi (Sandy).

"Këtu në Long Ajlënd (Long Island), jemi në plan për të rihapur më shumë se 30 parqe shtetërore për fundjavën e Ditës së Përkujtimit (Memorial Day), ndërsa vazhdojmë të bëjmë përparim të jashtëzakonshëm në riparimin e dëmit ndaj rrugëve, kopshteve, infrastrukturës dhe plazheve të parkut të shkaktuara nga super stuhia Sendi (Sandy)," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Rihapja në kohë e këtyre parqeve është veçanërisht e rëndësishme ndërsa fillon sezoni turistik i verës. Dhe duke filluar nga e shtuna, familjet dhe vizitorët e Long Ajlënd (Long Island) mund të shijojnë këtë destinacion të admirueshëm në Plazhin e Orientit (Orient Beach)."

Gjatë stuhisë, rruga dy milje e gjatë e hyrjes dhe vija bregdetare e Gardinërs Bei (Gardiners Bay) pësuan erosion të rëndë dhe katër pjesë të rrugës prej asfalti u dëmtuan. Pajisjet elektrike përgjatë rrugës së hyrjes u zbuluan. Të gjitha ndërtesat në park u përmbyten. Vërshimi i stuhisë dhe përmbytja dëmtuan dhe/ose shkatërruan duzina pemësh përgjatë rrugës së hyrjes dhe morën me vete një kasolle të ruajtësve të plazhit dhe tryezat e piknikut nga pjesa përpara plazhit.

Me ndihmën e Departamentit të Transportit të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Department of Transportation), rruga e hyrjes është rindërtuar dhe rreth 2,120 këmbë të Rrugës Shtetërore të Plazhit të Orientit (Orient Beach State Parkway) janë riparuar. Dy zona të pjerrëta "rip rap" janë instaluar për të mbrojtur rrugën e re përgjatë vijës bregdetare të Gardinërs Bei (Gardiners Bay). Mbrojtja e pjerrët rip rap është një shtresë e gurëve e krijuar për të mbrojtur dhe stabilizuar zonat që mund t'i nënshtrohen erozionit.

Riparime të tjera përfshijnë:

- Vendosjen e 4,500 jardë kub të rërës dhe zhavorrit për të krijuar një zone mbrojtëse prej 880 këmbë për të mbrojtur kompleksin e ndërtesës së parkut
- Zëvendësimin e 360 këmbë të Gabionëve, kafaze mbrojtëse të mbushura me gurë, beton të copëzuar dhe materiale të tjera përgjatë vijës bregdetare në hyrjen e parkut menjëherë në jug të vendit të pagesës
- Restaurimin e Mjediseve të Trajtimit të Ujit
- Restaurimin dhe ngritjen e të gjitha pajisjeve elektrike mbi zonat e përmbytjes
- Gradimin e plazheve të notit të Parqeve
- Heqjen e pemëve të rrezikshme
- Riparimin e tryezave të pinikut

“Ka qënë inkurajuese të shohim sasinë e punës dhe të angazhimit që është kryer për rihapjen e këtij parku shtetëror të admirueshëm gjatë gjashtë muajve të fundit. Pavarësisht nga detyra e madhe, e dinim se ishte thelbësore të siguroheshim se jo vetëm Plazhi i Orientit (Orient Beach) do të hapej përpara Ditës së Përkujtimit (Memorial Day), por të gjitha parqet dhe plazhet tona,” tha Komisionerja e Zyrës së Parqeve, Argëtimit dhe Ruajtjes Historike (Office of Parks, Recreation & Historic Preservation Commissioner) Rouz Harvi (Rose Harvey). “Që nga ekipet në fushë tek Komisioneri MekDonald tek vetë Guvernatori, kjo rihapje është një trashëgimi se puna si ekip është me të vërtetë mënyra më e mirë për të trajtuar sfidat më të vështira me sukses.”

Komisionerja e NYSDOT-së Xhoen MekDonald (Joan McDonald) tha, “Pas dëmit të madh të shkaktuar në Long Ajlënd (Long Island) nga super stuhia Sendi (Sandy), Guvernatori Kuomo (Cuomo) u angazhua për të riparuar shpejt plazhet e bregut jugor dhe rrugët që të çojnë tek to. Duke punuar së bashku me Komisioneren Harvi (Harvey), kemi ndihmuar në arritjen e këtij qëllimi për familjet që jetojnë këtu, pushuesit që udhëtojnë këtu dhe bizneset që mbështeten tek ta.”

Parku Shtetëror i Plazhit të Orientit (Orient Beach State Park) është i hapur çdo ditë, gjatë gjithë vitit, nga ora 8:00 e mëngjesit deri në perëndimin e diellit. Parku është një gadishull katër milje i gjatë që shtrihet drejt perëndimit në Gardinërs Bei (Gardiners Bay) pranë Pikës së Orientit (Orient Point). Parku është një mjedis i admirueshëm argëtimi, që njihet për zonën e tij të piknikut, plazhin e notit, kompleksin, shtegun e biçikletave, dyqanin e dhuratave, vendet e lojrave, peshkimin dhe kajakët. Parku është një Pikë Historike Natyrore Kombëtare, si dhe një Zonë e Rëndësishme e Zogjve Audubon dhe një mjedis banimi i rëndësishëm për zogjtë dhe bimët në rrezik të bregdetit.

Parku Shtetëror i Plazhit të Orientit (Orient Beach State Park) mirëpret mbi 350,000 vizitorë të parkut çdo vit. Kryqëzimi Verior i Long Ajlënd (North Fork of Long Island) është bërë një destinacion turistik i admiruar. Vizitorët në rajon shijojnë vreshta të kategorisë botërore, restorante të këndshme, kiosta të fermave, vende të fjetjes dhe mëngjesit, galeri arti, fanarëd he parkun. Në Parkun Shtetëror të Plazhit të Orientit (Orient Beach State Park) mund të arrihet kollaj me makinë, autobus, biçikletë dhe traget.

Parku do të hapet për herë të parë që nga stuhia e tetorit. Vizitorët e parkut do të shohin riparime të vogla të mjediseve në punë e sipër, krasitjen e pemëve, rimbjelljen e bimëve vendase dhe punën e kopshteve që vazhdon gjatë sezonit.

Zyra e Parqeve, Argëtimit dhe Ruajtjes Historike të Shtetit të Nju Jorkut (New York State Office of Parks, Recreation and Historic Preservation) mbikqyr 179 parqe shtetërore dhe 35 vende historike, që vizitohen nga 60 milionë njerëz çdo vit. Një studim i kohëve të fundit i porositur nga Parqet dhe Shtigjet e Nju Jorkut (Parks & Trails New York) zbuloi se Parqet e Shtetit të Nju Jorkut (New York State Parks) krijojnë 1.9 miliardë dollarë në veprimtari ekonomike çdo vit dhe mbështet 20,000 vende pune. Për më shumë informacion mbi ndonjë prej këtyre vendeve të argëtimit, telefononi 518-474-0456 ose vizitoni www.nysparks.com, lidhuni në Facebook, ose ndiqni në Twitter.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418